

Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti Juridik |
| Titulli i lëndës: | Negocimi dhe Draftimi i Kontratave dhe Dokumenteve tjera Komerciale |
| Niveli: | Master (LL.M.) ne kontrata dhe te drejten komerciale |
| Statusi lëndës: | E detyrueshme |
| Viti i studimeve: | |
| Numri i orëve në javë: | 4+1 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 5 ECTS |
| Koha / lokacioni: | / |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.Dr. Nerxhivane Dauti Mr.sc. Sefadin Blakaj |
| Detajet kontaktuese: | nerxhivane.dauti@uni-pr.edu sefadin.blakaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Draftimi i dokumenteve komerciale në veçanti kontratave është jashtëzakonisht i rëndësishëm për palët që përfshihen në transaksione të ndryshme ekonomike. Rëndësia e dokumenteve të shkruara komerciale shfaqet sidomos kur palët kanë mosmarrëveshje lidhur me të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga dokumentet komerciale të negociuara. Kjo do të thotë se varësisht se si është negociuar dhe draftuar një dokument do të varet funksionimi i një marrëdhënie kontraktore dhe komerciale por edhe mënyra se si do të zgjidhen mosmarrëveshjet eventuale në mes palëve. Në këtë drejtim ky kurs ka për qëllim ofrimin e njohurive për studentët: 1) si duhet të negociohet një dokument komercial por edhe si duhet të draftohet në atë mënyrë që palët ti kenë të qarta të drejtat dhe detyrimet në transaksion ekonomik dhe 2) si duhet të evitohet rreziku i mosmarrëveshjeve eventuale lidhur me transaksionin komercial. Përmes këtij kursi, studentët do të marrin njohuri për negociimin dhe draftimin e dokumenteve më të rëndësishme komerciale, në veçanti kontratave. Me këtë studentët do të aftësohen në të shkruarit gjuhësor të dokumenteve duke eliminuar të gjitha problemet e mundshme ligjore. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi kryesor i kursit qëndron në përgatitjen e studentëve për të draftuar të gjitha dokumentet komerciale që kërkohen prej një juristi. Në veçanti kursi synon ti ndihmoj studentët për detyrat e tyre që mund ti presin gjatë punës në të ardhshme sidomos: 1) si ti qasemi hartimit me kujdes të dokumenteve komerciale 2) si ta bëjmë një dokument të |

| | | | |
|--|---|------------------|------------------|
| | <p>besueshëm që ti përmbush nevojat në transaksion ekonomik 3) si të organizohen të drejtat dhe detyrat brenda një dokumenti në mënyrë efikase 4) si të zgjidhet gjuha që do të përdoret në dokument 5) shkrimi, i çartë, konciz dhe eliminimi i dykuptimësive 6) si të precizohen të drejtat dhe detyrat, 7) struktura e qartë e dokumentit etj. E gjithë kjo në funksion të realizimit të nevojave dhe evitimit të rrezikut në transaksione komerciale.</p> | | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dijë t'i interpretoj dhe zbatoj dispozitat juridike nga fusha e të drejtës civile në veçanti dokumenteve të negociuara kontraktuale; 2. Të kuptoj ndikimin e shprehjeve dhe terminologjisë juridike të përdorura në hartimin e dokumenteve ligjore dhe kontratave; 3. Të jenë në gjendje të negociojnë dhe draftojnë dokumente ligjore dhe kontraktore; 4. Të aftësohen për përdorimin e argumenteve verbale dhe me shkrim në çështjet e të ndryshme komerciale në emër të klientëve afarist 5. Të aftësohen për të shërbyer në institucione relevante në fushën komerciale si: institucioneve financiare, gjykatave, arbitrazhit etj. | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 4 | 15 javë | 60 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | 1 | 15 javë | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 5 javë | 5 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiime,seminare | | | |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose | | | |

| | | | |
|---|--|--|--|
| në shtëpi) | | | |
| Përgaditja përfundimtare për provim | | | |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |
| Totali | | | |

| | |
|--------------------------------------|--|
| Metodologjia e mësimëdhënies: | <p><u>Metodologjia:</u></p> <p>Kursi do të organizohet përmes diskutimeve, detyrave të draftimit të dokumenteve në klasë, rastet simuluese, draftimi i dokumenteve si detyrë shtëpie si dhe projekti final.</p> <p><i>Draftimi i dokumenteve në klasë:</i> gjatë vijimit të kursit studentët do të mësohen si të hartohet një dokument komercial që nga fillimi dhe deri në marrjen e një forme përfundimtare. Llojet e detyrave në klasë dhe të jenë të ndryshme duke i selektuar dokumentet më të rëndësishme. Hartimi i dokumenteve do të bëhet me diskutim të përbashkët me studentët gjatë orëve në klasë.</p> <p><i>Rastet simuluese:</i> Gjatë punës në klasë do të organizohen edhe raste simuluese të negocimit të dokumenteve komerciale.</p> <p><i>Draftimi i dokumenteve si detyrë shtëpie:</i> studentët do të kenë edhe detyra të shtëpisë për të hartuar dokumente të ndryshme komerciale të cilat do të sjellen te profesori në kohen e kërkuar. Në bazë të diskutimeve në klasë, studentët do të udhëzohen për haritmin e një dokumenti të ngjashëm detyrë shtëpie por që do të jetë punë e pavarur e studentit.</p> <p><i>Draftimi i projektit final:</i> Draftimi i një projekti final parashihet në javet e fundit të kusit. Ky projekt do të jetë draftimi i një dokumenti më kompleks dhe voluminoz i cili do të hartohet duke u bazuar në një rast të përshkruar (transaksion i imagjinuar) që do t’iu jepet studentëve si detyrë finale.</p> <p>Vëllimi i angazhimit: Angazhimi në kurs do të jetë 5 (pesë) orë një javë sipas skemës në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. 1 orë ligjërata dhe diskutime me profesorin e lëndës, b. 3 orë në javë profesori asistent (1 orë udhëzime dhe diskutime për draftime të dokumenteve dhe 2 orë ushtrime praktike (detyra)) dhe c. 1 orë ligjërata dhe diskutime profesori ndërkombëtarë-ligjërata nga distanca përmes sistemit elektronik Scype. |
|--------------------------------------|--|

| Metodat e vlerësimit: | <p>Metoda e vlerësimit: Vlerësimi do të bëhet përmes sipas skemes si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e studentëve 10% - Detyra grupore në klasë 10% - Detyra individual në klasë 20% - Detyra individual -detyrë shtëpie 20% - Detyra final (Projekti final) 40% <p>Llogaritja e notës:</p> <table border="1" data-bbox="609 630 1385 892"> <thead> <tr> <th>Përqindja e pikëve</th> <th>Përshkrimi i notës</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>95% - 100%</td> <td>Nota maksimale</td> </tr> <tr> <td>85% - 94%</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> </tr> <tr> <td>75% - 84%</td> <td>Shumë mirë</td> </tr> <tr> <td>65% - 74%</td> <td>Mirë</td> </tr> <tr> <td>55% - 64%</td> <td>Kalueshëm</td> </tr> <tr> <td>nën 55%</td> <td>Jo kaluese</td> </tr> </tbody> </table> | Përqindja e pikëve | Përshkrimi i notës | 95% - 100% | Nota maksimale | 85% - 94% | Shkëlqyeshëm | 75% - 84% | Shumë mirë | 65% - 74% | Mirë | 55% - 64% | Kalueshëm | nën 55% | Jo kaluese |
|------------------------------|---|--------------------|--------------------|------------|----------------|-----------|--------------|-----------|------------|-----------|------|-----------|-----------|---------|------------|
| Përqindja e pikëve | Përshkrimi i notës | | | | | | | | | | | | | | |
| 95% - 100% | Nota maksimale | | | | | | | | | | | | | | |
| 85% - 94% | Shkëlqyeshëm | | | | | | | | | | | | | | |
| 75% - 84% | Shumë mirë | | | | | | | | | | | | | | |
| 65% - 74% | Mirë | | | | | | | | | | | | | | |
| 55% - 64% | Kalueshëm | | | | | | | | | | | | | | |
| nën 55% | Jo kaluese | | | | | | | | | | | | | | |

Literatura

| | |
|-------------------------|---|
| Literatura bazë: | <p>Literatura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nerxhivane Dauti, “<i>E drejta e detyrimeve</i>”: Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë”, Prishtinë, 2008. - Nerxhivane Dauti, “<i>Praktikumi i kontratave</i>”, Prishtinë, 2006. - Stephen R. Guth, Esq, “<i>The Contract Negotiation Handbook: An Indispensable Guide for Contract Professionals</i>”, First Edition, Lulu Press, Inc., Morrisville, North Caroline, 2008. ISBN: 978-1-4357-0639-2. - Kenneth A. Adams, “<i>A manual of style for contract drafting</i>”, American Bar Association, 2004, ISBN, 1-59031-380-1 (pbk), e mundshme ne adreshen:http://books.google.com/books?id=n7jxMskU9MC&printsec=frontcover&dq=drafting+contracts&hl=en&ei=ZFINTdnMI4LssgbBmMyEDQ&sa=X&oi=book_result&ct=result&resnum=1&ved=0CCwQ6AEwAA#v=onepage&q=drafting%20contracts&f=false - Aspen Publishers, “<i>Drafting effective contracts – a practitioner’s guide</i>”, Second Edition, 2004, ISBN 0-7355-0376-1, e mundshme ne internet: http://books.google.com/books?id=hdd6gUrjXAMC&printsec=frontcover&dq=drafting+contracts&hl=en&ei=ZFINTdnMI4LssgbBmMyEDQ&sa=X&oi=book_result&ct=book-thumbnail&resnum=4&ved=0CD0Q6wEwAw#v=onepage&q&f=false - Barbara Child, “<i>Drafting Legal Documents: Principles and Practices</i>”, Publisher, West Group, 1992, ISBN 10: 0314003258 / 0-314-00325-8, ISBN 13: 9780314003256 - University of New South Wales, “<i>Drafting contracts: the Essentials</i>”, Faculty of Law, Centre for Continuing Legal Education, |
|-------------------------|---|

| | |
|-------------------------------------|--|
| | <p>2006</p> <ul style="list-style-type: none"> - SEC Plain English Handbook. E mundëshem për tu marr nga interneti në adresen: http://www.sec.gov/investor/pubs/englishhndbk.htm <p>Ligje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 29/78. - Projekt-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (drafti i projektligjit është në fazën finale të përfundimit i cili pritet të miratohet në Parlamentin e Republikës së Kosovës në vitin 2011) |
| Literatura shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> - Aleks Luarasi, “<i>Obligimet dhe kontratat ne përgjithësi</i>”, Luarasi, Tirane, 1998 - Charles L. Knapp, “<i>Rules of contract law</i>”: Selections from the Uniform Commercial Code, the CISG, the Restatement (second) of contracts and the UNIDROIT Principles, Aspen Law & Business, 1999 - Elizabeth Warren & Jay Lawrence Westbrook, “<i>The law of debtors and creditors: Text, cases and principles</i>”, Aspen Law & Business, 1996 - Robert L. Jordan & William D. Warren, “<i>Negotiable instruments, payments and credits</i>” fourth edition, Westbury, New York, 1997. |
| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në negocimin dhe draftimin e dokumenteve - Rëndësia e dokumenteve komerciale - Draftimi i dokumentit |
| Java e dytë: | <ul style="list-style-type: none"> - Negocimi i kontratave - Sqarime konceptuale lidhur me negocimin - Përgatitja e negociatave - Marrëdhëniet në mes klientit dhe juristit - Kompensimi - Koha |
| Java e tretë: | <ul style="list-style-type: none"> - Sekretet e negocimit - Manovrimet (Dredhitë) e negocim - Taktika e negocimit - Këshillat, kurthet dhe mashtrimet |
| Java e katërt: | <ul style="list-style-type: none"> - Negocimi i kushteve të kontratës - Shënimet e çarta gjatë negociatave |

| | |
|------------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Përformanca e negociatave - Arritja e qëllimit (objektivave) |
| Java e pestë: | <ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i kontratës - Rregullat themelore - Konsistenca - Gjuha standarde |
| Java e gjashtë: | <ul style="list-style-type: none"> - Hyrja e kontratës - Titulli - Klauzola hyrëse - Përshkrimi - Përmbajtja - Indeksi i definimit të termeve; |
| Java e shtatë: | <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha e përmbajtjes (pjesës kryesore) së kontratës - Shtirirja e kontratës (fletët e kontratës) - formati - organizimi i neneve - definimi i termeve - paqartësitë - dykuptimësitë - zgjedhja e fjalëve dhe frazave - specifikimi i dispozitave të kontratës - specifikimi i të drejtave dhe detyrave referencat; |
| Java e tetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Pjesa përfundimtare e kontratës - Klauzola përfundimtare - Nënshkrimi - Fleta e nënshkruar e sqarimit të nocioneve - Aneksi - Detyra në klasë; |
| Java e nëntë: | <ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i kontratës së shtblerjes - Konsultimi i dispozitave ligjore - Diskutim i draftimit: <i>Përmbajtja e kontratës</i> <i>Struktura e kontratës</i> <i>Negocimi i kushtet e kontratës</i> <i>Forma e kontratës</i> Detyra në klasë; |
| Java e dhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i kontratës së punës - Konsultimi i dispozitave ligjore - Diskutim i draftimit: <i>Përmbajtja e kontratës</i> <i>Struktura e kontratës</i> |

| | |
|------------------------------|--|
| | <p><i>Negocimi i kushtet e kontratës</i> <i>Forma e kontratës</i> -Detyra në klasë</p> |
| Java e njëmbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i autorizimit - Konsultimi i dispozitave ligjore - Diskutim i draftimit: - <i>Përmbajtja e autorizimit</i> - <i>Struktura e autorizimit</i> - <i>Forma e autorizimit</i> - Detyra në klasë |
| Java e dymbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Draftimi i testamentit - Konsultimi i dispozitave ligjor - Diskutim i draftimit: <i>Mjetet për hartim</i> <i>Dokumentet</i> <i>Intervista me palën</i> |
| Java e trembëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Vazhdim i hartimit të testamentit <i>Gjuha gjatë hartimit</i> <i>Forma e testamentit</i> Detyra në klasë; |
| Java e katërbëdhjetë: | -Evaluimi i kursit; |
| Java e pesëmbëdhjetë: | - Pranimi i draftimit të Projektit Final |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: | |
|--|--|
| <u>Integriteti akademik:</u> | |
| <ul style="list-style-type: none"> a) Gjatë vijimit të kursit duhet të ruhet integriteti personal dhe akademik i mësimdhënësit dhe studentit b) Pjesëmarrja e studentëve është e detyrueshme (çdo mungesë e paarsyeshme reflektohet në vlerësimin përfundimtar) c) Studentët duhet ti përmbushin detyrimet e dhëna gjatë punës praktike dhe detyrimeve të shtëpisë. Mungesa e përmbushjes së detyrimeve reflektohet në kalueshmërinë e provimit. d) Studentët duhet ti përmbahen rregullave disiplinore të mbarëvajtjes së kursit, ushtrimeve dhe detyrave në klasë. e) Plagjiatura dhe format e ndryshme të kopjimit janë të ndaluara dhe reflektohen në vlerësimin negative për studentin dhe ndëshkime tjera sipas rregullave përkatëse ligjore. | |